

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6566
E mërkurë, 23 mars 2022
çmimi 0.40 €

Bideni: Putini është mbështetur për muri në Ukrainë | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA "KURTI 2" SHËNON NJËVJETORIN E QEVERISJES | FAQE 4-5

OPOZITA IA NUMËRON KURTIT DËSHTIMET NJË PËR NJË



Tre liderët e partive opozitare, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, ia kanë numëruar Albin Kurtit dështimet për një vit

qeverisjeje të vendit. Liderët opozitarë kanë thënë se kjo qeveri është treguar e paafte në të gjithë sektorët. Sipas tyre, kjo qeveri ka dështuar në ekonomi,

në arsim, në politikën e brendshme dhe në atë të jashtme. Ata e kanë kritikuar qeverinë Kurti edhe për menaxhimin e keq të pandemisë

Importet më të mëdha, prodhimet minerale | FAQE 8



KURTI: PËR ZGJEDHJET SERBE NË KOSOVË DUHET TË KETË MARRËVESHJE MES DY VENDEVE

FAQE 3


AKTUALE



KRIVOKAPIQ: DEKLARATA E KURTIT PËR DEMARKACIONIN, 'PROVOKIM I PAPANUESHËM' F. 3

POLICIA PËR NJË JAVË SHQIPTOI 1 375 GJOBA F. 7

KOMUNA E PRIZRENIT DHE "HIDROREGJIONI JUGOR", MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI F. 6



EKONOMI



AUV SHTON KONTROLLIN PËR GRIPIN E SHPEZËVE F. 8

SPORT



PESË NDESHJET E MBETURA, PËRGATITJE PËR KUALIFIKIMET E ARDHSHE F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@ml.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mbz: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Navalny dënohet me nëntë vjet burgim

MOSKË, 22 MARS - Udhëheqësi i opozitës ruse, Aleksei Navalny, u dënua me nëntë vjet burgim nën akuzat për mashtrim dhe përbuzje të gjykatës. Procesi gjyqësor kundër tij u zhvillua në

një burg të sigurisë së lartë të martën, më 22 mars. Dënimin me burgim të Navalnyt kritikët e Kremlinit e shohin si përpjekje për ta mbajtur në burg kritikun e presidentit Vladimir Putin për aq

kohë sa të jetë e mundur. Gjykata vendosi, gjithashtu, që Navalny të dënohet edhe me një gjobë prej 1.2 milion rublash (rreth 11 500 dollarë). Navalny mund ta apelojë vendimin.



Bideni: Putini është mbështetur për muri në Ukrainë

KIEV, 22 MARS - Prej 27 ditësh Ukraina po përballet me forcat ruse që po tentojnë ta pushtojnë vendin, ndërsa presidenti amerikan Joe Biden ka paralajmëruar se Rusia mund të përdorë armë biologjike dhe kimike në fqinj. Megjithatë, Bideni thotë se tashmë presidenti rus Vladimir Putin "është më shpatulla pas murit, pasi ukrainasit po rezistojnë".

Reagimi i Bidenit erdhi pasi Pentagoni ka deklaruar më herët se ka "prova të qarta" që forcat ruse po kryejnë krime lufte në

vendin fqinj.

Përcaktimi që Bideni i bëri javën e kaluar Putinin si "kriminel lufte", si "diktator vrasës" dhe "bandit", kanë shkaktuar një krisje edhe më të thellë në marrëdhëniet me Rusinë.

Ministria e Jashtme ruse tha se ato ishin "të padenja për një figurë shtetërore të një rangu kaq të lartë" dhe rrezikoi prishjen e lidhjeve ShBA - Rusi.

Përmes një note proteste dorëzuar ambasadorit amerikan në Moskë, pala ruse paralajmëroi se marrëdhëniet mes Rusisë e ShBA-së mund të ndërpriten



Ukraina: Mbi 15 000 trupa ruse të vrarë në luftë

Rreth 15 300 trupa ruse janë vrarë që nga fillimi i luftës, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes e Ukrainës. Ministria rendit gjithashtu 509 tanke, 1 556 automjete luftarake të blinduara dhe 252 sisteme artilerie midis humbjeve ushtarake të Rusisë që kur pushtoi Ukrainën më 24 shkurt. Rusia ka dhënë vetëm një herë një shifër për humbjen e trupave të saj - 498 të vdekur deri më 2 mars, ndërsa ShBA-ja së fundmi vlerësoi se rreth 7 000 trupa ruse ishin vrarë në konflikt.

plotësisht.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e OKB-së ka urdhëruar tashmë Moskën ta ndalojë pushtimin e saj dhe një prokuror në gjykatën ndërkombëtare penale ka nisur një hetim për krimet e luftës.

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, forcat ruse janë "bllokuar në Ukrainë", ndërkohë që Mariupoli po përpiqet në maksimum për të mos iu dorëzuar rusëve. Në qytetin jugor shkatërrimet janë të pallogaritshme.

Një ditë më parë janë evakuuar 8 000 persona nga zonat e konfliktit, sipas zyrtarëve në Ukrainë.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, i është drejtuar parlamentit italian nëpërmjet

videolidhjes. Ai u ka thënë deputetëve italianë se shteti i tij është në prag të mbijetesës së luftës me Rusinë dhe ka paralajmëruar se Moska dëshiron të depërtojë në pjesën tjetër të Evropës, ka raportuar agjencia e lajmeve "Reuters". "Për trupat ruse, Ukraina është porta e Evropës, ata duan të hyjnë brenda, mirëpo barbarizmi nuk duhet të depërtojë", ka thënë ai. Presidenti ukrainas ka përsëritur thirrjet e bëra në adresimet para parlamenteve të shteteve të tjera që Rusia të sanksionohet më shumë.

Kryeministri italian Mario Draghi ka thënë se shteti i tij dëshiron ta shohë Ukrainën në Bashkimin Evropian dhe se duhet ofruar ndihmë ushtarake për të në mënyrë që të ndalen

masakrat.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka folur të martën edhe me Papa Françeskun dhe ka sugjeruar se Vatikani mund të luajë rol ndërmjetësues në përfundimin e luftës me Rusinë. Në një postim në "Twitter", Zelensky i shprehu Papës "situatën e vështirë humanitare" dhe se si korridoret e shpëtimit po bllokoheshin nga trupat ruse. Zelensky shtoi: "Roli ndërmjetësues i Selisë së Shenjtë [juridiksionit të Papës] për t'i dhënë fund vuajtjes njerëzore do të vlerësohej". Kjo deklaratë e Zelenskyt vjen pasi të hënën se ai tha se Jerusalemi mund të jetë potencialisht një vend për bisedimet e ardhshme të paqes të nivelit të lartë midis Ukrainës dhe Moskës.

Vazhdojnë kërkimet pas rrëzimit të aeroplanit në Kinë

KUNMING, 22 MARS - Ekipet e shpëtimit po vazhdojnë të kërkojnë për të mbijetuar pas rrëzimit të një aeroplani në jug të Kinës më 21 mars. Fluturimi i kompanisë "China Eastern Airlines", i nisur nga qyteti kinez Kunming për në Guangzhou, ka qenë duke bartur 132 pasagjerë

kur është përplasur në majat e provincës Guanksi.

Presidenti kinez, Xi Jinping, ka urdhëruar hetim të plotë.

Mediet lokale kanë thënë se ekipet e shpëtimit kanë identifikuar vendin ku është përplasur aeroplani dhe aty kanë gjetur valixhe, kuletat dhe

kartela identifikimi të pasagjerëve. Numri i viktimave ende nuk dihet, mirëpo ka shqetësime se nuk ka të mbijetuar. Kompanitë ajrore kineze kanë histori të mirë sa i përket sigurisë, pasi aksidenti i fundit masiv ka ndodhur 12 vjet më parë.



Kurti: Për zgjedhjet serbe në Kosovë duhet të ketë marrëveshje mes dy vendeve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se për mbajtje të zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të Serbisë në Kosovë duhet të ketë një marrëveshje në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Sipas një komunikate të qeverisë, Kurti i ka bërë këto deklarata gjatë një takimi virtual me ambasadorët dhe shefat e misioneve diplomatike dhe konsullore të Kosovës.

Kurti u ka thënë ambasadorëve dhe përfaqësuesve diplomatikë se “ne nuk dëshirojmë që t’ua pamundësojmë të drejtën e votës qytetarëve të Republikës sonë që kanë dyshetësi, por në të njëjtën kohë nuk mund të veprojmë në kundërshtim me ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendit”. Ai ka thënë se ka kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e vendeve të Quintit në Kosovë.

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova duhet ta shmangë “trajtimin e çështjeve një nga një” me Serbinë, duke shtuar se çështja e të drejtës së votës për komunitetin serb të Kosovës në zgjedhjet e Serbisë është shumë e rëndësishme. “Çështja e të drejtës së votës për komunitetin serb të Kosovës në zgjedhjet e Serbisë është shumë e rëndësishme, por ne duhet ta shmangim trajtimin e çështjeve

një nga një. Zgjidhja është marrëveshja gjithëpërfshirëse me Serbinë për njohje reciproke që do t’i rregullojë këto çështje njëherë e përgjithmonë. Tejzgjatja e arritjes së marrëveshjes do ta përkeqësojë angazhimin tonë për paqen në Ballkan”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Zëdhënësi i BE-së për Çështje të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, Peter Stano, ka thënë të martën, më 22 mars, në konferencën për shtyp të Komisionit Evropian, se Bashkimi Evropian shpreh keqardhje për atë që ai e ka quajtur “vendim të Kosovës për ta refuzuar propozimin e Quintit”, për votimin e serbëve në territorin e Kosovës për zgjedhjet në Serbi.

Vendet e Quintit janë: Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Italia, Gjermania dhe Franca. “BE-ja ka vepruar si lehtësues, përfaqësuesi i Lartë ishte i angazhuar në kontakte për të gjetur marrëveshje për zgjidhje praktike që do t’u mundësonte qytetarëve me dyshetësi të marrin pjesë në zgjedhje. Kemi bërë përpjekje të gjejmë zgjidhje praktike duke përdorur analogjitë që ishin vendosur në votime në të kaluarën”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, duke pohuar se Serbia ka luajtur rol konstruktiv e Kosova ka refuzuar. “Duke pranuar se Serbia ka qenë e hapur për gjetjen e zgjidhjes, ne shprehim keqardhje se konsensusi mes palëve në fund



nuk u arrit pas vendimit të Kosovës për ta refuzuar propozimin konstruktiv të Quintit”, ka thënë zëdhënësi i BE-së.

Ai e ka quajtur këtë vendim të jetë “në kundërshtim me përkushtimet e Kosovës për rrugëtim evropian dhe të ardhme demokratike dhe kundër parimeve të mbrojtjes së të drejtës demokratike të të gjithë qytetarëve, përfshirë edhe të atyre që i takojnë popullatës joshumicë”. “Tash ne presim nga

Kosova dhe Serbia të përmbahen nga veprimet dhe retorika, e cila mund t’i rrisë tensionet dhe, po ashtu, u bëjmë thirrje të dyja palëve të veprojnë me përgjegjësi dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive në negociata në kuadër të dialogut”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Ai ka thënë se në këtë moment nuk është në gjendje të paralajmërojë ndonjë takim në kuadër të dialogut, porse janë duke punuar në atë drejtim. “Po

punojmë në atë drejtim dhe i ftojme të dyja palët të veprojnë me përgjegjësi, në mënyrë që të jetë e mundur të organizohet një takim i tillë”, ka thënë Stano.

Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, është takuar të martën me përfaqësuesit politikë të serbëve të Kosovës. Takimi pasoi njoftimin e BE-së se autoritetet në Kosovë e kanë refuzuar kërkesën e Quintit për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të Serbisë të 3 prillit.

Krivokapiq: Deklarata e Kurtit për demarkacionin, ‘provokim i papranueshëm’

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Kryeministri i shkarkuar i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq, konsideron se deklarata e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, lidhur me demarkacionin është “provokim i papranueshëm”. Kurti ka deklaruar se me qeverinë e re malazeze do të diskutojë për çështjen e demarkacionit midis Malit të Zi dhe Kosovës.

Krivokapiq vlerëson se qëndrimi i Kurtit në fakt është paralajmërim për “aspiratat e rrezikshme të cenimit të integritetit territorial” të Malit të Zi. “Është interesant që nuk ka asnjë reagim nga presidenti i Malit të Zi dhe kandidati antikushtetues për kryeministër, Dritan Abazović”, ka shkruar Krivokapiq në “Twitter” të martën.

Më 21 mars, katër vjet nga ratifikimi i marrëveshjes për demarkacion në mes të Kosovës dhe Malit të Zi në Kuvendin e Kosovës, Kurti ka thënë se, për demarkacionin, shpreson t’i fillojë bisedimet me qeverinë e re malazeze për demarkacionin.



“Shpresojmë që do të ketë kushte të reja, me qeverinë e re për ta trajtuar edhe këtë çështje, për të cilën natyrisht që fajin e përgjegjësinë e ka qeveria e

atëhershme, e cila padrejtësisht, gabimisht e shumë dëmshëm ia dha Malit të Zi 8 200 hektarë të territorit të Kosovës”, ka deklaruar Kurti.

Kuvendi i Malit të Zi e ka miratuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë së Krivokapiqit në fillim të shkurtit, por ajo mbetet me mandat teknik deri në zgjedhjen

e qeverisë së re. I mandatuari për kryeministër është Dritan Abazović nga Lëvizja Qytetare URA.

Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi më 21 mars 2018, pas disa përpjekjeve të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje të opozitës së atëhershme për ta parandaluar ratifikimin me gaz lotsjellës. Marrëveshja është ratifikuar me një marrëveshje ndërmjet dy vendeve për korrigjimin e gabimeve të mundshme gjatë demarkacionit fizik të kufirit.

Në kohën e kryeministrit Ramush Haradinaj, Vetëvendosja e Kurtit pretendonte se Kosova me atë marrëveshje humbi më shumë se 8 mijë hektarë të territorit të saj.

Ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit të Kosovës me Malin e Zi ishte një nga kushtet e fundit të Bashkimit Evropian për heqjen e regjimit të vizave për Kosovën, gjë që ende nuk ka ndodhur.



QEVERIA "KURTI 2" SHËNON NJËVJETORIN E QEVERISJES

Opozita ia numëron Kurtit dështimet një për një

Tre liderët e partive opozitare, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, ia kanë numëruar Albin Kurtit dështimet për një vit qeverisjeje të vendit. Liderët opozitarë kanë thënë se kjo qeveri është treguar e paaftë në të gjithë sektorët. Sipas tyre, kjo qeveri ka dështuar në ekonomi, në arsim, në politikën e brendshme dhe në atë të jashtme. Ata e kanë kritikuar qeverinë Kurti edhe për menaxhimin e keq të pandemisë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 MARS - Më 22 mars të vitit të kaluar me 67 vota për, 30 kundër dhe asnjë abstenim Kuvendi i Kosovës pati zgjedhur qeverinë e re, të udhëhequr nga Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje. Një vit pas drejtimit të qeverisë, kryeministri Albin Kurti ka thënë të martën se ka pasur të arritura për përmbushjen e programit qeveritar. "Gjendja me pandeminë është vënë nën kontroll dhe situata është përmirësuar dukshëm, ndërsa është shënuar rritje ekonomike dhe rezultate të mira në luftën kundër krimit dhe korrupsionit", ka deklaruar kryeministri Kurti. Për punën njëvjeçare të qeverisë Kurti, liderët e partive opozitare kanë mbajtur konferenca për media, në të cilat e kanë kritikuar punën e kësaj qeverie. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e ka cilësuar të paaftë, jokompetente dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës qeverisjen njëvjeçare të Albin Kurtit. "Ajo çfarë e karakterizon paaftësinë e kësaj qeverie nuk është thjesht

performanca e dobët për realizimin e objektivave të saj. Karakteristika themelore e kësaj qeverie të paaftë është kostoja që ajo ka prodhuar për qytetarët e Kosovës", ka thënë Krasniqi në një konferencë për medie. Ai ka thënë se këto janë konstatime të bazuara në të dhëna reale, në kohë reale dhe në pasojë reale, që kanë shënuar fotografinë e qeverisjes nga marsi i 2021-s deri në mars të 2022-s. "Si rezultat i kësaj paaftësie, Republika e Kosovës për një vit qeverisjeje të kryeministrit Kurti nuk figuron as në hartën e investimeve strategjike, as në hartën e rëndësisë politike rajonale, as në hartën e partneritetit të qëndrueshëm me partnerët dhe aleatët strategjikë të Kosovës", ka shtuar ai. Madje, sipas Krasniqit, ka ndodhur krejt e kundërta pasi, si pasojë e regresit dhe stagnimit që e kanë karakterizuar këtë vit të qeverisjes, qytetarët e Kosovës kanë filluar të mos shohin më as të ardhme në atdheun e tyre. "Programi i qeverisë Kurti përgjithësisht ka qenë një lojë fjalësh. Aty ku nuk ka qenë lojë

fjalësh, ka qenë kopje planesh. Aty ku nuk ka qenë kopje planesh, ka qenë nocione librash. Por program të qëndrueshëm që vendos hapa konkretë për zhvillim ekonomik, për rend dhe ligj, për punësim, për integritet e mirëqenie, nuk ka pasur", ka shtuar ai. Sipas tij, ka vetëm disa elemente programore, të cilat, në fakt, sot na shërbejnë më së miri për ta parë e për ta matur paaftësinë e kësaj qeverie për zbatimin e programit. "Ka premtuar themelim të Fondit për Sigurime Shëndetësore. Sot nuk është në agjendë. Në vend të kësaj mund të flasim vetëm për keqmenaxhimin e pandemisë, për shkurtrimin e buxhetit për shëndetësi në kohë pandemie, për kontrata të dyshimta dhe për mungesë strategjike e vizioni për shëndetësi. Ka dështuar në ekonomi. Sot numri i të papunëve është rritur shumë, numri i të papunëve, të rinjve e të rejave që kërkojnë largimin nga Kosova është rritur jashtëzakonisht shumë, çmimet janë rritur jashtëzakonisht shumë, ndërsa të vetmet që s'janë rritur janë prodhimi, eksporti dhe punësimi dhe pagat", ka thënë kryetari i PDK-së. Krasniqi ka përmendur edhe shifrat e frikshme të muajit dhjetor e janar, ku kishim rreth 100 mijë të rinj e të reja që pritin vizën për t'u larguar nga Kosova. Në një listë të gjatë, Krasniqi ka thënë se kjo qeveri ka dështuar edhe në depolitizim të institucioneve, realizimin e

vetingut në drejtësi e prokurori, polici dhe inteligjencë, zbatimin e programit për banim të përballueshëm, themelimin e Fondit Sovran dhe Bankës Zhvillimore, ndërmarritjen e hapave konkretë për caktimin e pagës minimale, rritjen flagrante të energjisë dhe çmimeve etj. Sipas kryetarit Krasniqi, kryeministri Kurti ka ardhur në pushtet duke e shtruar politikën si ngjarje transformuese a, në fakt, për një vit, jo vetëm që s'ka transformuar asgjë, por është konvertuar në një politikan procedural pa kurrfarë vizioni politik e shtetndërtues. Krasniqi ka numëruar edhe dështimin e Kurtit në procesin e dialogut i cili po rrezikon që ta realizojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, ndërkaq e ka quajtur skandalozë politikën e jashtme. "Një vit i plotë, kur asnjë hap, as vendim, as veprim, as lobim nuk është ndërmarrë, qoftë për njohje të reja të shtetit të Kosovës, qoftë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare", ka thënë Krasniqi. Ai ka përmendur edhe refuzimin e gazit amerikan, si një nga vendimet më regresive që janë marrë në emër të institucioneve të Kosovës në dy dekada. Në fund lideri i PDK-së ka thënë se kjo performancë e dobët, e pasigurt, pa plan e me protagonizëm, pa vizion e me aventura, rrezikon ta thellojë edhe më tej jetën e qytetarëve të Kosovës dhe perspektivën e shtetit tonë. "Ne si opozitë, si Parti Demokratike, jemi

përpjekur të jemi një opozitë konstruktive, duke votuar e mbështetur qeverinë në çështjet e interesit shtetëror dhe karakterit shtetëror. Kontribut jemi përpjekur të japim edhe përmes ballafaqimit të qeverisë me realitetin e qytetarëve, në Kuvend përmes debateve parlamentare, si një kampion alarmi për ritmin e ngadalit dhe degradimin e qeverisjes. Dhe do të vazhdojmë të japim kontribut në çështjet e interesit e karakterit shtetëror edhe më tutje", ka thënë Krasniqi. Për punën njëvjeçare të qeverisë Kurti, ka mbajtur konferencë për medie edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, i cili ka folur për dymbëdhjetë dështimet e kësaj qeverie. "Përgjatë 12 muajve të shkuar kjo qeverisje është përcjellë me populizëm, arrogancë, arsyeime tek e shkuara e mungesë të qartë të vizionit zhvillimor për Kosovën. Është përcjellë edhe me braktisje të kauzave fundamentale të ngritjes në pushtet; siç është përcjellë me braktisje të halleve e nevojave të qytetarëve në secilën krizë me të cilën është ballafaquar për një vit", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se nga kriza e pandemisë, tek ajo e energjetikës e deri te rritja alarmante e çmimeve, qeveria Kurti ka vendosur t'i braktisë qytetarët dhe në betejën e tyre me përballueshmërinë, të sillet si vështruese e krizave. "Ajo ka dështuar të reagojë me kohë; siç ka refuzuar të ndërmarrë masa



adekuate që do të zbutnin secilën krizë. Kjo qeveri, në paaftësinë e saj vepruese për qytetarë, megjithatë ka qenë e aftë të kapë borde, kompani publike e institucione të pavarura me të afërm e familjarë. Kapja e këtyre institucioneve jetike për funksionalizimin e shëndoshë të shoqërisë ka rezultuar të jetë fatale në secilin ballafaqim me krizë”, ka deklaruar lideri i LDK-së.

Abdixhiku ka thënë se në politikën e jashtme kjo qeveri është karakterizuar nga skandale me dëme të pariparueshme për pozitën e vendit. “Me komunikime të turpshme e amatore dhe diskurs joadekuat diplomatik. Mbi të gjitha, është karakterizuar me mungesë të takimeve të rëndësishme në nivel ndërkombëtar; përjashtoj takimet e forumeve të përbashkëta me vendet e tjera të

Ballkanit Perëndimor. Izolimi i Kosovës po merr formë çdo ditë; dhe në rrethanat e reja gjeopolitike, mosaktivizimi i qeverisë sonë është humbje e jashtëzakonshme e mundësisë”, është shprehur ai, derisa ka thënë se në dialog kjo qeveri ka treguar mospërgatitje të plotë profesionale e të përkushtimit. “Përtej ndryshim-qëndrimeve themeltare të saj, ajo ka kaluar nga mosprioritizimi i dialogut si orientim, drejt e në transformimin teknik të tij; duke vendosur në rend të dytë kështu nevojën për marrëveshje përfundimtare drejt njohjes reciproke e hapjes së dyerve të Kosovës në integrimet euroatlantike”, ka pohuar Abdixhiku.

Ai ka theksuar se në politikën e brendshme qeveria Kurti ka qenë sa arrogante aq edhe konfliktuoze. “Në secilën përfshirje të saj, në drejtësi, sindikata, trupa të pavarur e me

vetë spektrin politik në vend, kjo qeveri ka dështuar ta sigurojë konsensusin minimal për një demokraci të shëndoshë e prosperuese. Tendencat e saj kontrolluese prej pushtetit absolutist janë përcjellë me sulme edhe ndaj mediave e ndaj fjalës së lirë. Dëshpërimi qytetar me një qeverisje të tillë, përtej zërit votues në zgjedhjet lokale të 17 tetorit e 14 nëntorit, është përcjellë edhe me largim masiv të qytetarëve tanë, të të rinjve e të rejave, profesionistëve e punëtorëve nga Kosova. Rreth 55 për qind e qytetarëve tanë e konsiderojnë largimin nga Kosova. Ky fakt duhet të na shqetësojë të gjithëve”, ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka dalë me një deklaratë për qeverinë Kurti. Haradinaj ka përmendur njëmbëdhjetë dështimet e qeverisë Kurti për një vit qeverisjeje. Ai ka thënë se kjo

qeveri ka dështuar në miratimin e Ligjit të Pagave dhe në fushën e energjisë. Haradinaj ka thënë se për një vit të punës kjo qeveri ka kapur bordet dhe institucionet e pavarura. “Menaxhimi i keq i pandemisë. Në muajt e parë shkalla tejet e ulët e vaksinimit të popullsisë. Mbyllja pa kriter e gastronomisë. Mbajtja e orës policore përtej çdo kriteri dhe arsyeje. Paketat e ndihmës ekonomike në kohën e pandemisë, pa asnjë efekt në rehabilitim të pasojave të saj”, ka thënë Haradinaj, duke dhënë kritika edhe në procesin e dialogut me Serbinë. “Vazhdimi i dialogut pa koncept me Serbinë. Dialog i nivelit teknik nga i cili Kosova nuk përfiton asgjë”, ka thënë ai.

Lideri i AAK-së ka theksuar se kjo qeveri ka treguar menaxhim joprofesional të situatave të sigurisë të krijuara në veri. Haradinaj e ka kritikuar qeverinë Kurti edhe për tenderët. “Dhënia

e dhjetëra tenderëve njëburimorë, është shndërruar në model të korrupsionit”, është shprehur ai. Sipas Haradinajt, kjo qeveri ka dështuar edhe në politikën e jashtme, duke përmendur mosantaresimin e Kosovës në asnjërin prej organizatave ndërkombëtare, mungesën e njohjeve, tërheqjen e ambasadorëve pa asnjë shpjegim dhe lënien bosh të vendit të tyre për muaj të tërë.

Ai ka thënë se kjo qeveri ka dështuar edhe në garantimin e pavarësisë së gjyqësorit. Haradinaj e ka kritikuar Kurtin edhe për qëndrimin e tij për luftën për liri dhe njëjtësimin e arkivave të Serbisë që kanë mijëra dosje të krimeve monstruoze kundër shqiptarëve me arkivat që nuk ekzistojnë të UÇK-së. Po ashtu, ish-kryeministri Haradinaj e ka kritikuar qeverinë Kurti edhe për fushatën sistematike institucionale kundër fjalës së lirë, mediave dhe gazetarëve.



Fillon krasitja e pemëve dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese në Mitrovicë

MITROVICË, 22 MARS (ER) - Në kuadër të projektit të mirëmbajtjes së hapësirave publike në komunën e Mitrovicës të martën ka filluar procesi i krasitjes së pemëve dhe drunjve dekorativë në hapësirat gjelbëruese në qytetin e Mitrovicës. Këtë

proces nga afër e kanë përcjellë nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Granit Tmava. Me këtë rast, nënkryetari Tahiri ka theksuar se komuna do t'u kushtojë vëmendje të veçantë

hapësirave gjelbëruese në mënyrë që ambienti i qytetit të ketë pamje edhe më të mirë. Ndërsa drejtori Tmava ka bërë me dije se Drejtoria për Shërbime Publike nga java e ardhshme do të fillojë mbjelljen e luleve dhe drunjve të tjerë dekorativë.



USAID-i përzgjedh Gjilanin si komunë partnere për zbatimin e programit për kontratën sociale



GJILAN, 22 MARS (ER) - Programi i USAID-it për Kontratën Sociale ka përzgjedhur Gjilanin komunë partnere për tre vjetët e ardhshëm. Konfirmimi u bë me dije nëpërmjet një letre që kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka pranuar nga dr. Silvia Susnjic, drejtoreshë e programit të USAID-it për Kontratën Sociale. "Përzgjedhja e komunës së Gjilanit është bërë në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe përkushtimit të treguar nga ana e kryetarit të komunës, të shprehur gjatë takimit me ekipin e Programit të USAID-it për Kontratën Sociale, për t'u

bërë komunë partnere dhe për të bashkëpunuar me ekipin e programit gjatë fazës së implementimit", thuhet në letërën e konfirmimit të dr. Silvia Susnjic. Më tutje në letër thuhet se "në emër të Programit të USAID-it për Kontratën Sociale, ju shpreh vlerësimin më të lartë me rastin e vendosjes së këtij partneriteti si dhe mirëpresim zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të ardhshme". Kjo letër konfirmimi përfshin aspektet e bashkëpunimit në fazën fillestare të implementimit të Programit të

USAID-it për Kontratën Sociale, me ç'rast komuna e Gjilanit zotohet për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në komunën e Gjilanit, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarëve komunalë në punëtoritë lidhur me reflektimin për sjelljen shoqërore, që do të realizohen gjatë muajit prill/maj 2022. Më 25 shkurt kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, kishte pritur në takim drejtoreshën e këtij programi të USAID-it, ku edhe u vunë bazat e partneritetit.

Komuna e Prizrenit dhe "Hidroregjioni jugor", marrëveshje bashkëpunimi

PRIZREN, 22 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, dhe kryeshefi ekzekutiv i KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A., Prizren, Zenel Zenelaj, kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancimin e projektit "Furnizimi me ujë të pijes për qytetin e Prizrenit nga burimi - Vermica". Prizreni që nga periudha e pasluftës vazhdimisht ka hasur në vështirësi për furnizimin me ujë të pijshëm në pjesë të ndryshme të qytetit dhe fshatrave.

Mungesa e reshjeve atmosferike gjatë viteve të fundit, rritja e hovshme e qytetit dhe infrastruktura ekzistuese komplekse e ujësjellësit kanë rritur më shumë vështirësitë për sigurimin e furnizimit stabil me ujë të pijshëm. Reduktimet e vazhdueshme janë dëshmia më serioze që duhet të ndërmerren masa për rritjen e kapaciteteve të ujit në komunën e Prizrenit. Qëllimi i marrëveshjes së bashkëfinancimit është zgjidhja afatgjatë e sigurimit të ujit të

pijshëm për qytetarët e komunës së Prizrenit për 30 vjetët e ardhshëm. Totaj ka thënë se përmirësimi i jetës së qytetarit dhe furnizimi 24 orë me ujë ka qenë një ndër prioritetet e tij, prandaj edhe kanë nënshkruar këtë marrëveshje për t'u ofruar qytetarëve të komunës së Prizrenit furnizim të pandërprerë me ujë të pijshëm. Ndërkaq kryeshefi ekzekutiv "Hidroregjioni jugor", Zenel Zenelaj, ka thënë se zgjidhja e problemit të ujit është çështje jetike.



Këshilli i Prindërve në Malishevë zgjodhi kryesinë dhe kryetarin



MALISHEVË, 22 MARS (ER) - Këshilli i Prindërve në nivel të komunës së Malishevës të martën ka mbajtur mbledhjen e parë, pas konsolidimit të këtyre këshillave në nivel të shkollave. Në këtë mbledhje në të cilën mori pjesë edhe drejtoresha e Arsimit, Arbëreshë Krasniqi dhe

kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Argjend Thaçi, këshilli i ka zgjedhur kryesinë, kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin. Fillimisht, Këshillin e Prindërve në nivel të komunës së Malishevës e ka përshëndetur drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit në komunën e

Malishevës, Arbëreshë Krasniqi. "Këshilli është organi i rëndësishëm dhe ju ftoj të punojmë bashkë, sepse këtë ua kemi borxh fëmijëve tanë dhe të gjithë atyre që kanë punuar dhe kanë dhënë shumë për vendin", ka thënë drejtoresha Krasniqi. Më pas, sipas propozimeve të

anëtarëve të Këshillit të Prindërve, është zgjedhur kryesia prej shtatë anëtarëve, të cilët më pas i kanë zgjedhur edhe kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin. Kryetar i Këshillit të Prindërve u zgjodh Agon Zogaj, nënkryetare Shpresa Krasniqi dhe sekretar Bali Buzhala.

Komuna Prishtinës merr aksion për lirimin e parkingjeve dhe hapësirave publike

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë ka ndërmarrë të martën një aksion për lirimin e parkingjeve dhe hapësirave

publike të gjelbëruara të cilat ishin uzurpuar dhe dëmtuar njëkohësisht nga qytetarë të ndryshëm në Bllokun e Vjetër të Prishtinës. Gjatë këtij

aksioni Drejtoria e Inspeksionit, pas lirimit të plotë të parkingjeve dhe hapësirave të gjelbëruara, me mbështetje edhe të NPL

"Hortikultura", ka rivitalizuar sipërfaqet e dëmtuara para banesave në këtë zonë, duke pastruar dhe duke mbjellë bari e fidanë të ndryshëm.



Tre të vdekur dhe 41 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 940 testeve, 41 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar tri raste të vdekjes.

Të martën janë shënuar 29 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 227 191. Në total numri i rasteve aktive është 642.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 384 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 820 008 doza të vaksinës. Deri më sot 819 455 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Prej 940 testeve, 41 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.



Ministri Latifi shkon në Turqi për ta forcuar bashkëpunimin në shëndetësi



për t'u theksuar qasja reale dhe efikase e funksionimit të sektorit publik dhe privat në Turqi dhe modeli i ndërtimit të veprimit të këtyre dy sektorëve.

Po ashtu, ministri Latifi ka diskutuar në Agjencinë Turke të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (TITCK) lidhur me sektorin farmaceutik, ku Selin Imamoglu nga ky institucion ka bërë një paraqitje të fakteve rreth funksionimit të sektorit farmaceutik në Turqi, duke filluar nga prodhimi, kontrolli i produkteve e deri te shpërndarja e tyre në qendrat spitalore.

Gjatë takimeve me zyrtarë shëndetësorë në Ankara ministri Latifi ka diskutuar me nikoqirët edhe për shërbimin ndërkombëtar shëndetësor si dhe për investimet shëndetësore të shtetit të Turqisë.

Të gjitha këto takime ministri Latifi i ka realizuar në spitalin e qytetit të Ankarasë.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka filluar një vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë. Ai të martën ka vizituar

disa institucione shëndetësore në Ankara. Fillimisht, ministri Latifi është njoftuar nga nikoqirët në Spitalin e Ankarasë, respektivisht nga dr. Fehmi Ajdinli nga Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhënie me Jashtë dhe e Bashkimit

Evropian lidhur me funksionimin e sistemit shëndetësor të Turqisë. Në diskutimet aty ministri Latifi i ka informuar zyrtarët në këtë spital me sistemin shëndetësor të Kosovës, kurse vizitën e ka konsideruar si një mundësi të

mirë për këmbim përvojash sa i përket ndryshimit të përgjithshëm të sistemit shëndetësor në Kosovë, duke vlerësuar se Turqia ka bërë përparim të madh në këtë sistem. Ai ka thënë se në këtë aspekt është

Policia për një javë shqiptoi 1 375 gjoba

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 MARS - Policia e Kosovës ka njoftuar se, bazuar në detyrat dhe autorizimet e saj ligjore dhe kushtetuese, është e përkushtuar për mbajtjen e rendit, garantimin e sigurisë publike si dhe menaxhimin dhe kontrollin e trafikut rrugor nëpër të gjitha rrugët e vendit.

Policia e Kosovës, gjegjësisht Njësia për Kontrollin e Autostradave, e mbështetur nga njësitë e tjera të Divizionit të Komunikacionit Rrugor në vazhdim të implementimit të planeve operative aktive si "Siguria në trafikun rrugor" dhe "Shtimi i masave të sigurisë në trafikun rrugor", gjatë një jave (14-20.03.2022) ka shqiptuar 1 375 gjoba për kundërvajtje të ndryshme në trafik, ka konfiskuar 5

automjete për ndalje të parregullt në autostradë, ka larguar nga trafiku 3 automjete të tjera, ka konfiskuar përkohësisht 6 targa të automjeteve të paregjistruara, ka identifikuar 9 kundërvajtës duke drejtuar automjetet nën ndikimin e alkoolit si dhe 21 shoferëve u është shqiptuar masë mbrojtëse e ndalimit të drejtimit të automjetit nga tre muaj deri një vit.

Përveç aktiviteteve policore në këtë aspekt, Policia e Kosovës ka apeluar të gjithë pjesëmarrësit në trafik të kenë kujdes më të shtuar, t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e trafikut rrugor si dhe t'u përshtaten kushteve të rrugës për të pasur një siguri më të madhe në trafik.

Për të gjithë ata pjesëmarrës në trafik, në veçanti për shoferët e automjeteve, të cilët bëjnë shkelje të ligjeve dhe rregullave të trafikut, do të ndërmerren masa ndëshkuese sipas ligjeve në fuqi.



Fillon trajnimi i rekrutëve të rinj të FSK-së

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se ka filluar trajnimi i rekrutëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). "Pas testeve të suksesshme, në

Qendrën tonë të Stërvitjes Bazike filloi trajnimi bazik nëntëjavësh i grupit të parë të rekrutëve të rinj, të përzgjedhur nga procesi i fundit rekrutues. Pas procesit intensiv të përgatitjeve

psiko-fizike, përvetësimit të vlerave dhe standardeve të nevojshme ushtarake, rregullave dhe procedurave, të gjitha të ndërlydhura me punën ekipore dhe disiplinën ushtarake, këta

djem e vajza do t'u bashkëngjiten radhëve të ushtrisë sonë. Forca djema dhe vajza! Ne kemi besim të madh në ju!", ka shkruar Mehaj në "Facebook".



Kurti hip në teleferik në Brezovicë

BREZOVICË, 22 MARS (ER) - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në aktivitetin e performancës së skijimit nga fëmijët e shkollave të ndryshme në kuadër të programit "Drejt Malit", në Brezovicë. Kjo është hera e parë që Qeveria e Kosovës mbështet organizimin dhe zbatimin e një programi të këtij lloji përmes të cilit u sigurohet fëmijëve, nxënësve të shkollave fillore të Kosovës qasje në aktivitete sportive - malore. "Me pesë partnerë të programit, me mbi 400 nxënës pjesëmarrës, e me mbi 100 instruktorë, vullnetarë, mësuesimdhënës, kujdestarë të veçantë dhe prindër, ky program shënon angazhimin tonë të përbashkët për zhvillimin e shëndetit të fëmijëve dhe edukimin joformal përmes aktivitetit fizik. Kjo bëhet e mundur vetëm atëherë kur ekziston lidhje e ngushtë e arsimit me sportin dhe e sportit me shëndetin", u shpreh kreu i qeverisë. Përtej kësaj, kryeministri Kurti ka

thënë se programi "Drejt Malit" flet edhe për kapacitetet madhështore që Malet e Sharrit kanë për zhvillimin e sportit dhe turizmit malor dhe se ky është sezoni i parë dimëror i 20 vjetëve të fundit, që qendra e skijimit Brezovica ka rregulluar statusin e saj të funksionimit dhe ka kthyer imazhin e saj prej një margaritari të bardhë.

Teksa ka folur për karakteristikat që e veçojnë Brezovicën, me shumë bukuri e histori dhe me një të ardhme të ndritshme para dhe e cila ndër vite ka sjellë vizitorë dhe sportistë nga anë e mbanë bota, kryeministri Kurti ka përmendur edhe pjesëmarrjen e dytë në Lojërat Olimpike Dimërore me dy sportistë të rinj, Albin Tahiri dhe Kiana Kryeziu.

Para medie, ndër të tjera, ai tha se i ka bërë përshtypje bashkëpunimi në mes të komuniteteve që punojnë dhe frekuentojnë qendrën e Brezovicës, duke e bërë kështu Brezovicën një tregim të suksessit



e komunitetit të integruar pa dallim.

Pas ceremonisë, së bashku me

zëvendësministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, kryeministri Kurti

vizitoi edhe pikën më të lartë të pistës së skijimit që shfrytëzohet nga skiatorët.

Importet më të mëdha, prodhimet minerale

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin shkurt 2022. Të dhënat nga Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 38 për qind në muajin shkurt 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021, gjegjësisht në vlerë prej 349.5 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 253.3 milionë eurosh sa ishte në vitin 2021. Eksporti mbulon importin 15.7 për qind.

Eksporti i mallrave në muajin shkurt 2022 kishte vlerën 65.2 milionë euro, ndërsa importi 414.7 milionë euro, që është një rritje prej 34.8-përqindësh për eksport dhe 37.5 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 28.9 për qind të eksporteve e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 23.7 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13.2 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 6.9



për qind prodhimet minerale; 5.6 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 21.0 për qind e përbëjnë produktet minerale; 10.9 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10.5 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 9.9 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 8 për qind

prodhimet e industrisë kimike; 7.6 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 6.5 për qind mjetet e transportit etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së (27) arritën në 19.3 milionë euro, ose rreth 29.6 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 15.3-përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (8.8 për qind), Italia (5.1 për qind), Bullgaria (2.4 për

qind) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së (27) ishin rreth 190.4 milionë euro, ose 45.9 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 27.8-përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Sllovenia (12.4 për qind), Gjermania (10.8 për qind), Italia (4.0 për qind) etj. Në muajin shkurt 2022 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 22 milionë euro, ose 33.8 për qind

të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 36.7-përqindësh.

Partnerët kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (13.4 për qind), Shqipëria (8.8 për qind), Serbia (6.3 për qind), Mali i Zi (3.9 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin shkurt 2022 arritën në 68 milionë euro, ose 16.4 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 36-përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (5.9 për qind), Maqedonia e Veriut (4.9 për qind) dhe Shqipëria (4.4 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 23.8 milionë euro, ose 36.6 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden ShBA-ja (23.6 për qind) dhe Zvicra (7.9 për qind).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 156.1 milionë euro, ose 37.7 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin Turqia (12.9 për qind) dhe Kina (9.5 për qind).

AUV shton kontrollin lidhur me gripin e shpezëve

PRISHTINË, 22 MARS - Në Kosovë nuk ka asnjë rast të konfirmuar me gripin e shpezëve dhe situata në terren është nën kontroll, kanë thënë zyrtarë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV) dhe infektologë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Lamir Thaçi, zëdhënës në Agjencinë e Ushqimit dhe

Veterinës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se monitorimi i situatës në terren është shtuar pas konfirmimit të pranisë së gripit të shpezëve, apo si njihet ndryshe virusi H5N8, në shtetin fqinj, Shqipëri.

Përveç importit të shpezëve, Thaçi tha se nga Shqipëria është ndaluar edhe importi i

vezëve. Autoritetet e Shqipërisë kanë njoftuar më 20 mars se kanë konfirmuar rastin e parë të gripit të shpezëve, kurse deri më 22 mars kanë ngordhur rreth 340 000 shpezë. Gripi i shpezëve kryesisht përhapet nga kontakti i drejtpërdrejtë midis zogjve të infektuar dhe atyre të shëndoshë dhe mund të bartet edhe te njerëzit.



Lufta në Ukrainë, bota rrezikohet nga një krizë ushqimore



Ndryshimi i klimës. Pastaj pandemia. Dhe së fundi lufta në Ukrainë. Kjo periudhë është katastrofike, dhe tani pritet një 'Annus Horribilis' (një vit i tmerrshëm) për sektorin e bujqësisë, që mund të vërë në rrezik sigurinë ushqimore në zonat më të varfra të globit, dhe që është i destinuar të ndikojë seriozisht edhe në konsumin e të ashtuquajturës bota e parë, ose vendeve më të zhvilluara të botës. Me sulmin rus në Ukrainë, sanksionet perëndimore që sollën edhe kundërpërgjigjen e Rusisë, tregu i plehrave kimikë po shkon drejt një krize me përmasa të paprecedenta: një kolaps i eksporteve dhe një rritje pasuese e çmimeve, që do të godasë rëndë prodhuesit në një moment kritik për Hemisferën Veriore, pikërisht në fillim të sezonit të mbjelljes së kulturave pranverore (misri, sojë, luledielli etj), dhe fazës së plehërimit për drithërat e vjeshtës siç është gruri.

Më 4 mars, Ministria ruse e Tregtisë, rekomandoi ndalimin e eksporteve të plehrave kimikë,

duke u ankuar për pamundësinë e garantimit të transportit, për shkak të sanksioneve perëndimore dhe efektin që kanë ato në dërgesat e mallrave drejt dhe nga Rusia.

Kjo situatë është e destinuar të shkaktojë pasoja të rënda në bujqësinë botërore. Rusia është eksportuesja kryesore në botë e plehrave kimikë, me 50 milionë tonë të prodhuar çdo vit (13 për qind e prodhimit botëror), dhe me një xhiro që në vitin 2020 arriti në rreth 7 miliardë dollarë.

Sa i përket Evropës, edhe Bjellorusia nuk do ta furnizojë dot me plehra kimikë në të ardhmen e afërt, pasi sanksionet e vendosura nga Bashkimi Evropian, synojnë gjithashtu importin e potasit (një përbërës kyç i plehrave kimikë), ku Minsku është ndër eksportuesit më të mëdhenj në botë.

Po ashtu Ukraina nuk do të lejojë më shitjen e plehrave dhe përbërësve për prodhimin e tyre (azot, fosfor dhe kalium) jashtë kufijve të saj kombëtarë, në përpjekje për të garantuar prodhimin bujqësor të vendit gjatë konfliktit. Rezultati është një rënie

e madhe e furnizimeve globale.

Por lufta po ndikon edhe mbi prodhimin dhe kostot e plehrave kimikë në një mënyrë më indirekte. Proceset industriale me të cilat prodhohen plehrat kërkojnë sasi të mëdha energjie. Për shembull llogaritjet që vetëm sinteza industriale e amoniakut, përmes një procesi kimik të njohur si procesi Haber-Bosch, harxhon 1-2 për qind të gjithë energjisë së prodhuar në planet.

Prandaj, kostot e prodhimit të plehrave kimikë, ndikohen drejtpërdrejt nga ato të lëndëve djegëse të përdorura në prodhimin e energjisë, dhe rrjedhimisht të naftës dhe gazit, çmimet e të cilave janë rritur shumë qëkur ka nisur lufta në Ukrainë.

Situata ndërlikohet më shumë nga fakti se lufta vjen pas 2 vitesh pandemi, që e kishin goditur tashmë rëndë tregun e energjisë dhe transportin, duke shkaktuar rritje të çmimit të plehrave kimikë dhe zvogëluar shumë normën e fitimit për fermerët.

Vitin e kaluar, Kina njoftoi një

ndalim të eksporteve të plehrave kimikë deri në qershor të këtij viti, pas mbylljes së disa fabrikave, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë. Prodhuesi kryesor në botë, norvegjezja Yara International, e uli prodhimin me 40 për qind në vitin 2021, për shkak të rritjes së çmimit të gazit në Evropë.

Po kështu kanë vepruar edhe disa kompani amerikane. Rezultati ishte një rritje e çmimeve të plehrave dhe përbërësve të tyre. Për shembull nitrati i amonit, u rrit me 260 për qind vetëm gjatë vitit 2021. Dhe në një situatë tashmë komplekse, sulmi rus ndaj Ukrainës përfaqëson goditjen përfundimtare.

Gazi dhe nafta kanë arritur rekorde të reja çmimesh, dhe kostoja e plehrave po kap majat.

Në këto kushte, ekspertët thonë se kostot në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë do të bëhen gjithnjë e më të paqëndrueshme, ndaj përveç rritjes së çmimeve në supermarkete, konsumatorët mund të përballen me mungesën e disa produkteve ushqimore.

Efektet që do të ketë lufta ndaj prodhimit global të ushqimit, do të shihen konkretisht vetëm pas disa muajsh. Mjerisht, ato ka të ngjarë të rezultojnë dramatike në shumë vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Vetëm vitin e parë të pandemisë, në vitin 2020, u rrit nga 8.4 në 10.4 për qind përqindja e popullsisë globale pa qasje në sasi ushqimi të mjaftueshëm, një rritje që korrespondon me rreth 100 milionë njerëz të cilët nuk kanë më qasje tek vaktet e rregullta ushqimore.

Që atëherë, situata është përkeqësuar më tej. Në fakt, Ukraina dhe Rusia janë edhe ndër eksportuesit kryesorë të grurit, misrit dhe lulediellit. Dhe sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), konflikti mund të rrisë me 8-22 për qind çmimet e këtyre ushqimeve. Në skenarin më të mirë, numri i njerëzve të keq-ushqyer në botë mund të rritet me 7.6 milionë deri në vitin 2023. Në skenarin më të keq, kjo rritje do të jetë 13.1 milionë njerëz.

Gjibraltari kap superjahtin e një oligarku rus


Një superjaht në pronësi të një miliarderi të sanksionuar rus është konfiskuar nga autoritetet e Gjibraltarit, tha sekretari i Transportit i Mbretërisë së Bashkuar, Grant Shapps. "Axioma" i përket oligarkut

Dmitry Pumpysky. Pumpyskyt udhëheq një kompani për prodhimin e tubave të çelikut, e cila furnizon gjigantin rus të gazit "Gazprom".

Mbretëria e Bashkuar ka ndërmarrë sanksione kundër

Pumpyskyt javën e kaluar, duke e vlerësuar pasurinë e tij neto në 2.44 miliardë dollarë. Sanksionet e saj zbatohen edhe në territoret jashtë shtetit të Mbretërisë së Bashkuar, duke përfshirë Gjibraltarin.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Pesë ndeshjet e mbetura, përgatitje për kualifikimet e ardhshme

PRISHTINË, 22 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës U21 e ka mbajtur stërvitjen e dytë në kuadër të përgatitjeve për dy ndeshjet kundër Sllovenisë për kualifikimet e Kampionatit Evropian 2023. Për dallim nga stërvitja e së hënës, e cila më shumë ishte regjenerim për lojtarët, stërvitja e ditës së martë ishte me punë intensive, ku drejtori teknik Albert Bunjaku, i cili po e udhëheq ekipin, ua ka transmetuar lojtarëve filozofinë e tij të lojës dhe atë çfarë pret nga ta në dy ndeshjet e radhës. Para stërvitjes Bunjaku ka mbajtur një konferencë për medie, ku i pranishëm ishte edhe kapiteni

Edvin Kurtulush. Bunjaku ka thënë se synimi i tij në pesë ndeshjet e mbetura të kualifikimeve për Evropianin 2023 është që të grumbullohen 40 deri 50 për qind e pikëve në dispozicion por, sipas tij, qëllimi kryesor është përgatitja e ekipit për kualifikimet e ardhshme që nisin në pranverën e vitit 2023. "Nga 23 lojtarë të ftuar në këtë grumbullim, 11 prej tyre kanë të drejtë loje në kualifikimet e ardhshme dhe këtu është edhe fokusi ynë. Pra, ndërtimi i një ekipi kualitativ për ciklin e ardhshëm kualifikues", ka thënë Bunjaku. Ai e ka vlerësuar Slloveninë si

kundërshtarë shumë të fortë fizikisht, por ka thënë se këto dy ndeshje do të jenë shumë motivuese për të dhe për lojtarët. Ndërkaq, kapiteni i ekipit, Edvin Kurtulush, ka shprehur optimizëm para këtyre dy ndeshjeve. "Do të përpiqemi ta përgatim sa më mirë gjeneratën e re për kualifikimet e ardhshme dhe për t'u kualifikuar në Evropian. Besoj se me këtë ekip që kemi dhe me trajnerin aktual do të bëjmë punë të mirë", ka thënë Kurtulush. Në këtë grumbullim mungon Ismet Lushaku, i cili nuk ka udhëtuar fare pasi ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19.



Sot dhe nesër zhvillohet xhiroja e fundit në Ligën Unike



PRISHTINË, 22 MARS - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e 14-t në Ligën Unike, që është e fundit për garat e rregullta, ku do të përcaktohet renditja përfundimtare. Tri vendet e para tashmë janë siguruar. Golden Eagle Ylli është në vendin e parë me 12 fitore e një humbje, Peja e dyta me nëntë fitore e katër humbje, si dhe Prizreni 16 me tetë fitore e pesë humbje, ndërsa Teuta, Rahoveci dhe Tirana kanë nga gjashtë fitore e shtatë humbje. Vendi i parë dhe i dytë kualifikohen direkt në gjysmëfinale, ndërsa në "play-off" do të luajnë vendi i tretë

me atë të gjashtë dhe i katërti me të pestin. Ndeshja e parë zhvillohet mes Rahovecit dhe Pejës, ku "vreshtarët" synojnë fitoren për të siguruar një vend më të lartë në renditje, ndërkohë që "verdhezinjët" kanë siguruar vendin e dytë. Sfida e dytë zhvillohet mes skuadrave shqiptare, Vllaznisë dhe Teutës. Shkodranët kanë tri fitore e dhjetë humbje, kurse dursakët kanë gjashtë fitore e shtatë humbje. Të enjten ndeshen Prizreni 16 dhe Golden Eagle Ylli. Prizrenasit kanë siguruar vendin e tretë me tetë fitore e pesë humbje, kurse therandasit janë në

vendin e parë me 12 fitore e një humbje. Takimi i fundit zhvillohet ndërmjet Tirana Neptun dhe Kamzës. Tiranasit kanë gjashtë fitore e shtatë humbje, kurse skuadra e Kamzës ka dy fitore e 11 humbje.

LIGA UNIKE - JAVA 14

Të mërkurën takohen:
17:00 Rahoveci - Peja
19:00 Vllaznia - Teuta

Të enjten takohen:
17:00 Prizreni 16 - Golden Eagle Ylli
19:00 Tirana - Kamza

Orges Bunjaku do ta përfaqësojë Kosovën

Prishtinë, 22 mars - Futbollisti i talentuar nga Kosova, Orges Bunjaku, ka vizituar të martën Federatën e Futbollit të Kosovës, ku është pritur nga kryetari Agim Ademi dhe KE i FFK-së. Në këtë takim është zyrtarizuar vendimi i lojtarit për t'u bashkuar Përfaqësueses së Kosovës. Bunjaku ka lindur në Zvicër dhe deri tash ka përfaqësuar këtë shtet në të gjitha ekipet përfaqësuese të grupmoshave. Megjithatë, tani

ka vendosur ta dëgjojë zemrën dhe ta përfaqësojë vendlindjen e prindërve të tij. 20-vjeçari aktualisht luan në kategorinë e dytë të futbollit francez Grenoble, ku u transferua nga skuadra e njohur zvicerane Basel. "Kryetari Ademi e përgëzoi Orgesin për vendimin e marrë dhe i shprehu mirëseardhje në ekipin 'dardan', derisa falënderoi edhe prindërit e tij dhe të gjithë lojtarëve të tjerë që i kanë rritur dhe

edukuar fëmijët e tyre në frymën e atdhedashurisë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ndërkaq Orges Bunjaku falënderoi kryetarin Ademi për interesimin e vazhdueshëm dhe u shpreh i lumtur që në të ardhmen do ta përfaqësojë vendin e prindërve të tij. Ai theksoi se e pret me padurim ditën kur do ta veshë fanellën e Kosovës dhe do të japë maksimumin e tij për t'i arritur objektivat.



Giresse zëvendëson Sahitin me Dellovën

PRISHTINË, 22 MARS - Mbrojtësi i spikatur i KF Ballkanit, Lumbardh Dellova, i është bashkuar Përfaqësueses së Kosovës në grumbullimin për dy miqësoret e këtij

muaji kundër Burkina Fasos dhe Zvicrës. Ai është ftuar nga përzgjedhësi Alain Giresse, pasi futbollisti i Hajdukut të Splitit, Emir Sahiti, është lënduar dhe nuk do të

jetë në dispozicion për këto dy miqësore. Dellova aktualisht është pjesë e skuadrës lidere të Superligës së Kosovës, derisa më herët ka luajtur në Hajduk të Splitit dhe në Prishtinë.

Barça planifikon rikthimin e Messit, opSION edhe transferimi i Haalandit

BARCELONË, 21 MARS - Xavi Hernandez po arrin ta rikthejë Barcelonën në "shina". Fitorja e fundit në "El Clasico" me "poker" golash ishte sinjali më i qartë. Drejtuesit e klubit blaugrana nuk mjaftohen me kaq. Joan

Laporta kërkon ta rikthejë Barcelonën e lavdishme që dikur "pushtonte" Spanjën dhe Evropën. Numri një i klubit së fundmi është pyetur mbi mundësinë e një transferimi të mundshëm në "Camp Nou" të Leo Messit

dhe Erling Haaland. "Asgjë nuk është e pamundur. Afrimi i Haalandit është i vështirë, por jo i pamundur. Janë shumë faktorë që ndikojnë në këtë operacion, e para dhe më e rëndësishmja, përpara se t'i afrojmë lojtarë,

duhet të shesim. Rikthimi i Messit? Ashtu siç e thashë për Haalandin, asgjë nuk është e pamundur, e vetmja gjë që mund të them me siguri është se mes palëve nuk ka pasur kontakte", ka deklaruar presidenti i Barcelonës.



Bajrami: Kam lindur në Zvicër, por ndihem shqiptar

TIRANË, 22 MARS - Mbrojtësi i bashkuar për herë të parë me kombëtaren shqiptare, Adrian Bajrami, është shprehur se zgjedhi të ishte pjesë e ekipit "kuqezit" dhe jo e përfaqësueses së Zvicrës, sepse ai është shqiptar. Duke folur në konferencën për medie përpara ndeshjes miqësore me Spanjën, Bajrami theksoi që shpreson që të ketë mundësi të debutojë sa më shpejt me ekipin "kuqezit". "Jam shumë i lumtur të jem pjesë e kombëtares. Shpresoj të ambientohem sa më shpejt dhe të arrijmë të ndeshja. Zvicra? Unë jam shqiptar. Jam lindur dhe rritur në Zvicër kam kaluar shumë vite me futbollin në Zvicër, pastaj kalova te Benfica, por unë ndihem shqiptar. Mbrojtësin që ke si model? Berat Gjimeshi dhe Kumbulla, të gjithë janë shumë të mirë", ka thënë



Bajrami. "Dita e parë ishte shumë e mirë për mua. Mendova se do të ishte më e vështirë por nuk ishte, por ka lojtarë si Lenjani dhe Gjimeshi që më afruan shumë dhe shpresoj të ndihem edhe më mirë. Debutimi? Shpresoj. Unë jam gati. Jam në formë. Kam luajtur gjithmonë me Benficën. Jam kapiten i ekipit tim. Jam gati.

Benfica? Është kënaqësi e madhe të luash për një klub si Benfica. Kam mësuar shumë aty, jam rritur si person, si futbollist. Me kalimin e kohës do të shohim çfarë do të ndodhë. Tifozët? Shpresojmë që do të vini dhe të na mbështetni sepse do ta japim maksimumin për Shqipërinë", ka deklaruar Bajrami.

LeBron bën ligjin në Cleveland, Duranti magjik për Brooklynin

CLEVELAND, 22 MARS - Pavarësisht prej humbjes me rezultat 113-106 në fushën e Philadelphias, Miami është skuadra e parë e kualifikuar në fazën "play-off" në Konferencën e Lindjes. Një ndeshje me rivalitet, ku për vendasit u dallua Maxey me 27 pikë. Fiton edhe skuadra e lakersave, që mposhti Clevelandin me rezultat 131-120. LeBron Jamesi realizoi një "triple double", me 38 pikë, 11 rebounde dhe 12 asistime. Pavarësisht prej mungesave të shumta, ekipi i



Brooklynit fitoi me shifrat 114-106 ndaj Utah Jazzit. Për miqtë u dallua Mitchell me 30 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për Netsin shkëlqeu Kevin Duranti me 37 pikë. Skuadra e Chicagos, falë 52

pikëve të dyshes DeRozanLaVine, mundi me rezultat 113-99 Toronton, ndërsa Dallasi fitoi me rezultat 110-108 ndaj Minnesotas (Powell 22 pikë).

REZULTATET

CHARLOTTE - NEW ORLEANS	106-103
CLEVELAND - LAKERS	120-131
DETROIT - PORTLAND	115-119
BROOKLYN - UTAH JAZZ	114-106
PHILADELPHIA - MIAMI	113-106
CHICAGO - TORONTO	113-99
HOUSTON - WASHINGTON	115-97
OKLAHOMA - BOSTON	123-132
DALLAS - MINNESOTA	110-108

SHKURT

Torino interesohet për Strakoshën

Skuadra e Torinos nuk është shumë e kënaqur me portierin Vanja Milinković-Savić, por pakënaqësi ka edhe me Etrit Berishën, i cili gaboi në ndeshjen ndaj Genoas. "TuttoMercatoWeb" raporton se ëndrra e Torinos është portieri i Napolit, Aleks Meret, i cili aktualisht po vuan nga një lëndim. Një opSION për klubin është edhe Thomas Strakosha, i cili mund të vijë me parametra zero nga Lazio. Për portierin e kombëtares shqiptare nuk kanë munguar adhuruesit si në Serinë A ashtu edhe në Premierë Ligë dhe e ardhmja e tij ende mbetet në dyshim.

Kloppi shihet si pasardhës i Ancelottit

Humbja në "El Clasico" me Barcelonën me rezultat 4-0 ka "trazuar ujërat" te skuadra e Real Madridit. Pavarësisht dallimit në pikë që kanë katalanasit dhe madrilenët, kjo humbje i ka bërë drejtuesit e Realit të mendojnë edhe për stolin e skuadrës që pritet ta kenë në sezonin e ardhshëm. Sipas asaj që raporton "Marca" "Los Blancos", me shumë siguri do t'i ndajnë rrugët me Carlo Ancelottin, me Kloppin që është rikthyer në listën e madrilenëve. Por, trajneri gjerman ka bërë me dije se ai nuk e ka në plan të largohet nga "The Reds" deri në fund të kontratës së tij që skadon në vitin 2024. Kështu, Real Madridi duhet të bëjë një ofertë të majme te Kloppi, për të tentuar t'ia ndryshojë mendjen. Gjermani më tej kishte shtuar se synim i tij është që të pushonte për rreth një vit dhe më pas të kthehet në zejen e trajnerit.

Britania e Madhe dhe Irlanda do të organizojnë 'Euro 2028'

Britania e Madhe dhe Irlanda e kanë fituar garën për ta organizuar Kampionatin Evropian që mbahet në vitin 2028. Dy vendet ishin të parat që aplikuan në konkursin e hapur nga UEFA për ta organizuar ngjarjen më të madhe për përfaqësueset në Evropë. Turqia e tërhoqi kandidaturën e saj pasi dështoi në dy ofertat e fundit për ta organizuar Euron më 2016 dhe 2024, ndërsa oferta e planifikuar e Rusisë nuk është marrë as parasysh. Procesi zyrtar i tenderimit pritej të zvarritej deri në shtator të vitit 2023, por nuk pati asnjë ofertë tjetër dhe UEFA do t'i shpallë organizatorët shumë më herët, duke bërë me dije se MB dhe Irlanda përmbushin kërkesat teknike të organizatorëve, gjë që konsiderohet si një formalitet. Pesë shoqatat e futbollit – të Anglisë, Skocisë, Uellsit, Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës – njoftuan qëllimin e tyre për të konkurruar për turneun vetëm muajin e kaluar duke përjashtuar një fushatë më ambicioze për ta arritur Kupën e Botës 2030.

Van Nistelrooy, synim i PSV-së

Ruud van Nistelrooy është kandidati i preferuar i PSV-së për ta marrë pozitën e trajnerit sezonin e ardhshëm, raporton "Eindhovens Dagblad". Roger Schmidt do të largohet në fund të sezonit dhe skuadra e Eindhovenit dëshiron që ish-sulmuesi të largohet nga ekipi i të rinjve për ta marrë kontrollin e ekipit të të rriturve. Van Nistelrooy ka treguar rezultate të mira me lojtarët e akademisë, gjë që e ka bindur PSV-në që ta vë në krye të skuadrës së parë për edicionin e ri. Klubi do ta respektojë kohën e mbetur të Schmidt në skuadër dhe në fund të sezonit do t'i ndajnë rrugët me të. Sulmuesi legjendar do ta marrë drejtimin më pas të skuadrës dhe do ta sfidojë veten edhe më shumë, sidomos në elitën e futbollit holandez.

Mercedesi e konsideron fitore podiumin e Hamiltonit, vlerëson rivalët e Ferrarit

Te Mercedesi kanë festuar të gjithë si një fitore vendin e tretë të Lewis Hamiltonit në garën e parë sezonale zhvilluar në Bahrein. Makina kampione në Formula 1 ka vështirësi këtë fillimsezon dhe fakti që u rendit në

vendet 3-4, pas dy makinave Ferrari, konsiderohet mjaft i rëndësishëm, pasi u grumbulluan mjaft pikë. "Kjo garë e parë ishte si një test për ne dhe fakti që u ngjitëm në podium me një pilot është i rëndësishëm. Limituam dëmet karshi

rivalëve tanë, duke parë atë që i ndodhi Red Bullit dhe duke parë se përpara nesh është një Ferrari në formë", u shpreh Toto Wolff. Në fund, drejtori sportiv i makinës gjermane vlerëson paraqitjen e Ferrarit dhe rikthimin e saj

te fitorja. "I përhëndes dhe përgëzoj pilotët e Ferrarit për dy vendet e para në garën e Bahrein. E kanë merituar atë triumf pas problemeve në sezonin e fundit. Tani botërori bëhet edhe më interesant", ka shtuar Wolff.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Mobilshop Shkodrani” SH.P.K. me pronar Avdulla Shkodra, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811866112 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mobilshop Shkodrani” D.O.O. Avdulla Shkodra, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811866112 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Mobilshop Shkodrani” L.L.C. Avdulla Shkodra, has come to the decision to quit its business: 811866112 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Kompania Regjionale e Mbeturinave
„Ambienti“ SH.A.Rr. Xhem Sadrija pn. Pejë
Njësia Operative Pejë, Klinë, Istog.

KONKURS PUBLIK

KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA “AMBIENTI”- SH.A. PEJË

-NJËSIA OPERATIVE NË ISTOG

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit me Nr. 03/L-212 Të punes, dhe neni 3 të paragrafi 1 udhëzimit administrative Nr. 07/2017 Për themelimin e mardhënjes së punës në sektorin publik

Pozita e ofruarë :

3 / tre / PUNËTOR FIZIKË- / NË Mbledhjen e Hedhurinave /

Detyrat dhe përgjegjësit :

- 1.Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
 - 2.Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çeseve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
 - 3.Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
 - 4.Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
 5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres Shoferit. Kryepunëtorit
 6. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Shoferit. Kryepunëtorit. Menaxherit të Operatives, Kyeshelit Ekzekutiv
- Konkursi i shpallur është për afat gjashtë mujorë me mundësi vazhdimi

Kushtet:

- Shkollimi fillorë
- Aftësi fizike dhe psikike të deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit, aplikacionet merren në zyrën e Njësia Operative Istogë .dokumentet dorëzohen në zyrën njësia Operative Istog ,te gjitha te fotokopjuara .

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek “REB BULLI”, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ferat Arifi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta".
- ▶ Albin Shabani shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Enver Hadri".
- ▶ Besnik Uka shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLT "arkitekt sinani".
- ▶ Elmedina Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit 10,11,12 te SHMLM " Dr Xheladin Deda".
- ▶ Djellza Berisha shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit 10,11,12 te SHMLM " Dr Xheladin Deda".
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

